

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Irani thotë se është kundërpërgjigjur pas sulmeve amerikane
ADRESA	https://ekonomiaonline.com/irani-thote-se-eshte-kunderpergjigjur-pas-sulmeve-amerikane/
BURIMI	ekonomiaonline.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 15:40:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
KOHA E PORTALIT	nuk jepet <i>Ky portal nuk e deklaroi datën dhe nuk e shkruan as të dukshme. Mbetet vetëm ora jonë e kapjes.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	064b71334f57fb127d595702c32a135c5edd426b5a2aaff05f54a6908360f79e
TEKSTI	c6c5858678234952d166c0a6675d7185d989a5c7b3d2d48ac139974c0eea7e58
PAMJA	9a7fd73e46bce2bac9d95af095601acb3fce04c107873234fb6c9804657e43f9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	69d856e4fe5096d027ee5b99338c608d1143a6f904ef4dd46e4b9f57671a4cf1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	54dd2333b6815cc9ee49b1eacc7ddb168ecd2c0e9855c2b5b6b06fa16afbc7fc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/69d856e4fe5096d027ee5b99338c608d1143a6f904ef4dd46e4b9f57671a4cf1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



-
-
-

E Diel

06 Sht 2026

- [Ekonomi](#)
- [Politikë](#)
- [Nacionale](#)
- [Komuna](#)
- [Lifestyle](#)
- [Sport](#)
- [Kalendari](#)
- [Video](#)

Kërko...

Irani thotë se është kundërpërgjigjur pas sulmeve amerikane



-
-

Prishtinë | 06 Sht 2026 | 10:28 | Nga Ekonomia Online

Irani tha të dielën se forcat e tij sulmuan një dron detar amerikan që po përpiqej të hynte në Ngushticën e Hormuzit, disa orë pasi shënjestruan anije në kundërpërgjigje ndaj sulmeve amerikane ndaj tri cisternave të naftës.

Rundi i fundit i përplasjeve, i cili nisi me sulmet amerikane javën e kaluar, vjen në një kohë kur lufta gjashtëmujore mes tyreShteteve të Bashkuara dhe Iranit ka hyrë në një ngërç.

Irani ka ruajtur kontrollin mbi Ngushticën strategjike të Hormuzit, ndërsa Uashingtoni vazhdon bllokadën detare ndaj porteve iraniane.

Uashingtoni po synon po ashtu që të godasë ekonominë iraniane, duke vendosur sanksione ndaj subjekteve që kanë lidhje financiare me Republikën Islamike, në përpjekje për ta detyruar atë të nënshtrohet.

Trupat e Gardës Revolucionare Islamike (IRGC), thanë të dielën se “sulmuan një mjet lundrues ushtarak amerikan pa ekuipazh” që po përpiqej të hynte në ngushticë, sipas një deklarate që u transmetua nga televizioni shtetëror.

Disa orë më herët, IRGC-ja tha se forcat e saj detare “shënjestruan tri cisterna naftë në një rrugë të paautorizuar në Ngushticën e Hormuzit dhe tri anije të lidhura me Amerikën vrasëse të fëmijëve në zona të tjera”.

Ajo paralajmëroi anijet që të mos tentojnë të kalojnë përmes rrugëve të pamiratuara.

Të shtunën, Komanda Qendrore e ushtrisë së SHBA-së (CENTCOM), e cila mbikëqyr operacionet ushtarake amerikane në rajon, tha se ka goditur cisterna të lidhura me IRGC-në, duke e akuzuar krahun më të fuqishëm të ushtrisë iraniane se ka tentuar, pa sukses, të qëllonte ndaj anijeve luftarake amerikane.

“Pas sulmeve të pasuksesshme të Iranit, CENTCOM çaktivizoi përgjithmonë cisternën e naftës së papërpunuar të IRGC-së, M/T Downy, në brigjet e ishullit Harg, si dhe M/T Stark 1 pranë Jaskut”, tha CENTCOM-i.

“Forcat amerikane gjithashtu shkatërruan plotësisht cisternën e naftës së papërpunuar M/T Kylo, e cila nuk kishte ngarkesë, në Gjirin e Omanit, duke e goditur anijen në disa pika kritike për ta bërë atë të papërdorshme, pasi ekuipazhit iu dha urdhër që ta braktiste anijen”.

Një video e publikuar nga CENTCOM-i tregonte zjarr dhe flakë të mëdha që ngriheshin në ajër pasi predhat goditën anijet.

Sipas saj, tri anijet ishin “pjesë e një rrjeti në hije, me vlerë miliarda dollarë, që financon IRGC-në dhe grupet e saj të lidhura në rajon”.

Ndërkohë, Garda Revolucionare iraniane pretendoi se dy anijet luftarake amerikane që kishte shënjestruar ishin “detyruar të tërhiqeshin” pasi “kishin pësuar dëme”, por CENTCOM-i tha se ato anije arritën t’u shmangeshin me sukses sulmeve iraniane.

Komandanti i CENTCOM-it, admiral Brad Cooper, tha pas operacionit: “Nëse qëlloni ndaj dy prej anijeve tona, ne do t’ju shkaktojmë një kosto edhe më të madhe ekonomike – duke nxjerrë nga përdorimi tri prej anijeve tuaja”.

Ministria e Jashtme iraniane kritikoi Uashingtonin për sulmet ndaj cisternave të naftës, duke i cilësuar ato si “veprime të paligjshme dhe agresive”.

SHBA-ja po tenton që të rrisë presionin ndaj Teheranit lidhur me çështjen e Hormuzit – ku kalon një e pesta e furnizimeve botërore të naftës – dhe udhëheqësi amerikan, Donald Trump, disa herë ka thënë se SHBA-ja kontrollon këtë rrugë të rëndësishme.

Nënpresidenti amerikan, JD Vance, ndërkaq, ka thënë se SHBA-ja nuk do të rinisë bisedimet derisa Irani të ndalë sulmet ndaj anijeve tregtare në Ngushticën e Hormuzit/REL

Benzema mund të transferohet në Premierligë
Read more

abnëndaia


•
•

Të ngjashme




• [06 Sht 2026 |](#)

[Shpërthen vullkani në Indonezi, kaos në trafikun ajror, pezullohen fluturimet në 6 aeroporte](#)




• [06 Sht 2026 |](#)

[Bilokimi detar kundër Iranit, avioni i padukshëm amerikan patrullon mbi ujërat rajonale](#)




• [06 Sht 2026 |](#)

[Zgjedhjet në lindje të Gjermanisë mund të sjellin në pushtet guvernatorin e parë nga AfD-ja](#)




• [06 Sht 2026 |](#)

[Nga muaji tetor fillon linja e re zvicerane mbështetëse për viktimat e abuzimit online](#)



• [06 Sht 2026 |](#)

[Fëmija bie nga vetura në lëvizje në Gjermani, përplasët më pas nga ambulanca](#)




• [06 Sht 2026 |](#)

[Rama për Veliajn: Ishte talent i madh që nuk e mbajti peshën e pushtetit](#)



• [06 Sht 2026 |](#)

[Netanyahu e quan Katarin "shtet armiqësor", ndërsa Doha përplasët me Iranin](#)



• [06 Sht 2026 |](#)

[Emisarët amerikanë mbërrijnë në Kiev, priten nga Zelensky](#)



06 Sht 2026

Berisha në SHBA, takim me përfaqësuesit e Diasporës: Në 10 vitet e fundit, 46% e shqiptarëve janë larguar

SHFAQJË TJERA

Lajme më të

- **FUNDIT**
- **19:20 - Sveçla: Nderim për pjesëtarët që dhanë jetën në krye të detyrës**
- **18:40 - Kurti në 27-vjetorin e Policisë: Falë punës së tyre, krimi s'ka vend në Kosovë**
- **18:31 - Haxhiu: Nga 176 kadetët e parë në Vushtrri, Policia e Kosovës u rrit në mbi 9 mijë zyrtarë**
- **17:58 - Edhe 10 ditë deri te verdikti, më 16 shtator Specialja shpall aktgjykimin për ish-krerët e UÇK-së**
- **17:49 - Java e ardhshme vazhdon me temperatura mbi 30 gradë**
- **17:32 - Shpërthen vullkani në Indonezi, kaos në trafikun ajror, pezullohen fluturimet në 6 aeroporte**
- **17:01 - Hoti në mbështetje të Kujtim Shalës dhe Hykmete Bajrami, poston fotot e tyre me mbishkrim simbolin e LDK-së**
- **17:00 - Kanin: Kosova veproji me bindjen se Uashingtoni është gjithmonë aty, Kurti nuk shkon mirë me askënd**

Të gjitha të ditës

VIDEO



Video

Sveçla: Nderim për pjesëtarët që dhanë jetën në krye të detyrës



Video

Kurti në 27-vjetorin e Policisë: Falë punës së tyre, krimi s'ka vend në Kosovë



Video

Haxhiu: Nga 176 kadetët e parë në Vushtrri, Policia e Kosovës u rrit në mbi 9 mijë zyrtarë



Video

Kadrijaj: Nuk do të qeverisim me Kurtin, gjashtë kushtet tona janë për interes të Kosovës



Video

Qehaja: 1 shtatori do të duhej t'i zinte nxënësit me tekste shkollore, mësimi tërëditor e ardhmja e shumë shkollave

Kult





•

[Heidi Lushtaku heq mbiemrin e burrit nga rrjetet duke ngritur dilema](#)



•

[Për çka “s’mund të ankohet” Rina Balaj?](#)



•

[Soni shfaqet plot stil, mahnit me paraqitjen e fundit](#)



•

[Santiana publikon pamje më shoqëri të një mashkulli, situata duke serioze](#)



•

[Bebe Rexha marton vëllain, e ‘djeg’ ndejën nën ritmet e muzikës popullore shqiptare](#)

Adresa:
Rr. "Mark Isaku", Nr. 12, B2, Prishtinë, Republika e Kosovës

Redaksia:
049 289 299

Marketingu:
049 174 555

Email:
[\[email protected\]](#) [\[email protected\]](#)

[Impressum](#)

[Themeluar nga Faton Osmani](#)

Arkivi i lajmeve

[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)
[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)
[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)
[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)

2017

[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)

2018

[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)

2019

[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)

2020

[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)

2021

[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)

2022

[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)

2023

[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)

2024

[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)

2025

[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator Tetor Nentor Dhjetor](#)

2026

[Janar Shkurt Mars Prill Maj Qershor](#)
[Korrik Gusht Shtator](#)

Regjistrohuni për të shkarkuar dhe shfrytëzuar videot në kualitet të lartë.

[Kyçu Regjistrohu](#)

Menu

- [Ekonomi](#)
- [Politikë](#)
- [Video](#)
- [Sport](#)
- [Opinione](#)
- [Nacionale](#)
- [Lifestyle](#)
- [Kult](#)
- [Arte](#)
- [Komuna](#)
- [Siguri](#)
- [Kalendari](#)
- [Kuriozitete](#)
- [Turizëm](#)
- [Reza](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.